



	Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit	Instituciju Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	12.49/2019
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.	23/07/2019
Data/Datum/Date:	



PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 23 korrik 2019

Z. Shekip Fazliu, Sekretar
Telekomi i Kosovës Sh.A.

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 29/2019

Kohavision
kundër
Telekomit të Kosovës

Inderuari z. Fazliu,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, më 8 janar 2019, e ka pranuar ankesën e znj. Ardiana Thaçi Mehmeti, gazetare/autore e KTV-Kohavision (ankuesja), të cilën e ka parashtruar kundër Telekomit të Kosovës (TK), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka në dispozicion Avokati i Popullit, kuptohet se ankuesja, nëpërmjet postës elektronike, disa herë i është drejtuar TK-së me kërkesa për qasje në dokumente publike. Më 8 qershor 2018, ankuesja ka kërkuar qasje në dokumente publike, përkatësisht ka kërkuar qasje në kontratën që TK-ja e ka lidhur për objektin e TK-së që ndodhet në sheshin “Nëna Terezë”. Më 12 qershor 2018, ankuesja ka kërkuar qasje në dokumente publike, përkatësisht ka kërkuar qasje në të gjitha kontratat që TK-ja i ka lidhur për objektet që “Vala” i shfrytëzon me qira në komunën e Prishtinës. Më 24 tetor 2018, ankuesja e ka përsëritur kërkesën e datës 12 qershor 2018, duke iu referuar edhe prononcimit dhe premitimit publik që ish-kryeshefi ekzekutiv i TK-së e kishte dhënë në emisionin “Interaktiv” të KTV-së se do t’i lejohet qasja në dokumentet e kérkuara. Megjithatë, ankuesja nuk ka marrë përgjigje.

Më 11 shkurt dhe më 12 mars 2019, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë TK-së lidhur me çështjen e ankueses dhe, më 3 prill 2019, ka marrë përgjigje nga zyrtarja e TK-së për Komunikim me Qytetarë. Megjithatë, përmes kësaj përgjigje, Avokati i Popullit është njoftuar vetëm për kërkesën e parë të datës 8 qershor 2018, por jo edhe për kërkesën e datës 12 qershor 2018. Prandaj, më 15 maj 2019, Avokati i Popullit i është drejtuar përsëri sekretarit të TK-së, duke kërkuar informata për veprimet që TK-ja i ka ndërmarrë apo që planifikon t’i ndërmarrë sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, në drejtim të përgjigjes së kérkesat e ankueses për qasje në dokumente publike.

Më 31 maj 2019, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga zyrtarja e TK-së për Komunikim me Qytetarë, nëpërmjet së cilës është njoftuar për kërkesat e ankueses për qasje në të gjitha kontratat që TK-ja i ka lidhur për objektet që “Vala” i shfrytëzon me qira në komunën e Prishtinës. Në këtë përgjigje, TK-ja ka konsideruar se kërkesa për qasje në të gjitha kontratat që TK-ja i ka lidhur për objektet që “Vala” i shfrytëzon me qira është jo e precizuar dhe se teknikisht e bën të pamundur identifikimin dhe ofrimin e informatave të tilla dhe ka konsideruar se ankuesja duhet ta precizojë dhe ta qartësojë kërkesën. Ndërsa, sa i përket qasjes në kontratën për marketing që Telekomi i Kosovës e ka lidhur me kompaninë “Flexus”, TK-ja ka vlerësuar se ka kufizime në ofrimin e informatave, sepse bëhet fjalë për ruajtjen e interesit komercial dhe ruajtjen e interesave tjera ekonomike të korporatës, duke iu referuar nenit 12.1.7 të Ligjit nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike.

Avokati i Popullit, me këtë rast, vëren se kërkesa e ankueses ishte e qartë: “[...] kërkojmë nga Telekomi që të na mundësoj qasjen në të gjitha kontratat e objekteve që i shfrytëzon Vala me qira në Komunën e Prishtinës.”¹; si dhe pyetjet e dërguara në po të njëjtën ditë janë të qarta dhe konkrete: “[...]. Sa është qiraja mujore e objektit ku është vendosur Telekomi i Kosovës në Sheshin “Nënë Tereza”? [...]”² Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se TK-ja fare nuk është përgjigjur në kërkesat e parashtruara nga ankuesja për qasje në dokumente publike, duke rënë në kundërshtim të plotë me nenin 7, paragrafi 8, të LQDP-së, sipas të cilit institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për ta arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm, si dhe ta informojë kërkuesin për të drejtën që e ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.

Avokati i Popullit vë në pah se kufizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike duhet të ketë përjashtim, gjë që përcaktohet me nenin 12, paragrafi 1, të LQDP-së, me të cilin shprehimisht përcaktohen situatat për refuzimin e së drejtës për qasje në dokumente. Sidoqoftë, nen 12, paragrafi 3, i LQDP-së e përcakton mundësinë e kufizimit të ndonjë pjesë të dokumentit të kërkuar, për arsyet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 12, ndërsa pjesët e mbetura të dokumentit bëhen publike. Më tej, në rastet kur refuzohet kërkesa për qasje në dokumente publike, institucioni publik, i cili e refuzon qasjen në dokumentin në tërësi, apo e refuzon pjesërisht, obligohet të nxjerrë aktvendim me shkrim lidhur me arsyet e refuzimit.³

Megjithatë, kufizimi sipas nenit 12 të LQDP-së nuk nënkupton ndalimin apo mohimin e së drejtës për qasje në dokumentin e kërkuar, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj. Avokati i Popullit konstaton se dështimi për të nxjerrë një vendim në formën adekuate dhe me një arsyetim të qëndrueshëm përbën keqadministrim. Po ashtu, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës për përdorim të mjeteve juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë *Kushtetuta*), në nenin 41, paragrafi 1, parashevë të Drejtë për Qasje në Dokumente Publike: “Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.” Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtët nen përcakton: “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim

¹ Kërkesa e datës 8 qershori 2018, ora 09:41.

² Kërkesa e datës 8 qershori 2018, ora 4:31 PD

³ Ligji nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, nen 9 [Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes].

të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: “*Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike.*”

Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parashëh edhe nenin 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: “*Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...*”

Për më shumë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) që, sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-ja ka vlerësuar: “*T'i mohosh publikut informacione mbi funksiononim e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.*”⁴

Më tej, GjEDNj-ja, në rastin *Stell and Morris v The United Kingdom*, i datës 15 maj 2005, ndër të tjera, konsideron se në një shoqëri demokratike edhe grupet e vogla dhe ato joformale duhet të jenë në gjendje që t'i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive dhe se ekziston një interes i fortë publik që ua mundëson grupeve dhe individëve të jashtëm që të kontribuojnë në debatin publik, duke dhënë informacione me interes të përgjithshëm (paragrafi 89).⁵

Duke pasur parasysh rolin e mediave dhe të publikut në një shoqëri demokratike dhe duke pasur parasysh se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, Avokati i Popullit konsideron se kërkesa e ankueses për qasjen në dokumentet publike, si e tillë, ka bazë në Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe të llogaridhënieve së institucioneve në raport me kërkesat e qytetarëve, që ata ta realizojnë këtë të drejtë në mënyrë sa më efikase, Avokati i Popullit i:

REKOMANDON


- 1. Telekomit të Kosovës që, në pajtim me legjislacionin në fuqi, t'i ofrojë ankueses qasje në dokumentet e kérkuara.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kérkuara në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

⁴ Case of Observer And Guardian V. The United Kingdom, (Application no. 13585/88, 26 November 1991.

⁵ Rasti *Stell and Morris v The United Kingdom*, (Aplikimi nr. 68416/01, 15 maj 2005).

05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete,...duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmí Jashari
Avokat i Popullit